

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin nr. 597, datë 31.8.2016 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruktion i rrugës “Mujo Ulqinaku” dhe rehabilitimi i fasadave”, Fier” botuar në Fletoren Zyrtare nr.166, datë 31.8.2016 në faqet 20191 dhe 20192 korrigjohet gabimi material dhe konkretisht në tabelën e pronarëve të shpronësuar, për pasurinë me nr. 38/883. Sipërfaqja e shpronësuar prej 218 m² do të ndahet në këto dy numra pasurie si më poshtë vijon:

- Pasuria nr. 3/82 shpronësohet për sipërfaqen 110 m² me pronarë Mynevere Gilani, Mimoza Sulkaj, Albana Gilani dhe Zehra Agalliu; dhe

- Pasuria nr.3/883 shpronësohet për sipërfaqe 108 m² me pronarë Mynevere Gilani, Mimoza Sulkaj, Albana Gilani dhe Zehra Agalliu, Fatbardha Kotoni dhe Adil Kotoni.